

**KUVENDI KOMUNAL I FERIZAJT,
NË SHËRBIM TË PUSHTETIT APO TË
INTERESIT QYTETAR?**



Raport i monitorimit të punës së Kuvendit Komunal
për periudhën janar – shtator 2023.

Autor: Rexhep Maloku
Redaktore: Albulena Nrecaj

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Rockefeller Brother Fund.

Përkrahur nga:



Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave	4
2. Hyrje.....	5
3. Përmbledhje e përgjithshme.....	6
4. Metodologjia	8
5. Thelbi i mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Ferizajt gjatë periudhës janar-shtator 2023 ...	9
5.1. Kuvendi nis punën pa plan vjetor pune	9
5.2. Përplasja për (mos)faljen e tatimit në pronë	11
5.3. Edhe mbledhja e dytë nisi pa plan vjetor pune	11
5.4. Inatet e nivelit qendror reflektohen në atë lokal	12
5.5. Kontestimi i procesverbalit.....	14
5.6. Ndërmarrjet komunale s’kanë kujt t’i raportojnë	15
5.7. KASH-i i mirë, KASH-i i keq.....	16
5.8. Seanca që zgjati dy ditë për rreth 60 mijë euro subvencion	18
5.9. Sherri për tokën e kontestuar	20
5.10. Seanca e buxhetit në hije të akuzës për kërcënim.....	22
6. Kuvendi në sytë e kuvendarëve dhe të shoqërisë civile	24
6.1. (Jo)përfaqësimi	24
6.2. (Jo)transparenca.....	25
6.3. “Arroganca” e pozitës përballë opozitës dhe qytetarëve	26
6.4. Opozita “pikë e pesë”	28
6.5. Debati “i mbytur” publik.....	29
7. Konkluzionet.....	32
8. Rekomandimet.....	34

I. Lista e shkurtesave

INPO - Iniciativa për Progres

KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

LVV - Lëvizja Vetëvendosje

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

LDK - Lidhja e Demokratike e Kosovës

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

2. Hyrje

Meqë kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, që përbëhet prej anëtarëve të zgjedhur drejtpërdrejt nga votuesit në zgjedhje lokale, organizata Iniciativa për Progres – INPO ka vlerësuar punën e Kuvendit Komunal të Ferizajt gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti për të parë dhe analizuar vendimet, por edhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve ferizajas. Ky raport ka një përmbajtje ndryshe nga raportet klasike të monitorimit të punës së Kuvendit, të bazuar në indikatorë ligjorë apo indikatorë teknikë. Ky raport mëton të sjellë thelbin e punës së Kuvendit përmes një qasjeje vlerësuese të aspekteve përmbajtësore të seancave, debatit, angazhimit të anëtarëve të kuvendit për të adresuar problemet e qytetarëve dhe sfidat e kohës, si dhe qasjen e ekzekutivit të komunës ndaj kuvendit komunal.

Në pjesën e hyrëse të raportit pasqyrohen karakteristikat e secilës mbledhje veç e veç duke fokusuar në debatin e zhvilluar dhe mënyrën e vendimmarrjes me qëllim që gjithësecili lexues i raportit ta krijojë vetë një vlerësim për punën nëntëmujore të Kuvendit. Tutje, janë paraqitur vetëvlerësimet e anëtarëve të kuvendit për punën e tyre, respektivisht shefave të tri partive politike më të mëdha të përfaqësuara në kuvend dhe të dy pjesëtarëve të shoqërisë civile për punën e Kuvendit Komunal të Ferizajt dhe për nivelin e debatit publik lokal në përgjithësi, e atij politik në veçanti. Në fund të raportit janë të listuara II konkluzione dhe II rekomandime për Kuvendin Komunal dhe për ekzekutivin e Ferizajt. INPO vlereson se adresimi i këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve mund t'i kontribuojë theksueshëm përmirësimit të performancës së Kuvendit të Komunës dhe përmirësimit të jetës publike në Ferizaj.

Në përgjithësi, nga ky raport del se Kuvendi Komunal i Ferizajt nuk po e përmbush plotësisht rolin e vet për adresimin e kërkesave të qytetarëve dhe nuk po harton politika që do të përmirësonin dukshëm jetën e qytetarëve të komunës së Ferizajt. Gjendja bëhet edhe më shqetësuese duke pasur parasysh mungesën e debatit të mirëfilltë në Kuvend, i cili e ka për detyrë ligjore dhe kushtetuese që të ruajë dhe fuqizojë frymën e demokracisë lokale, si institucioni që ka lidhjen më të drejtpërdrejtë të qeverisjes lokale me votuesit dhe me qytetarët në përgjithësi.

3. Përmbledhje e përgjithshme

Kuvendi Komunal i Ferizajt gjatë periudhës janar-shtator 2023 i ka mbajtur dhjetë seanca, nëntë prej tyre të rregullta, një të jashtëzakonshme dhe asnjë solemne, me të cilat do të mund të nderoheshin përvjetorë ngjarjesh historike, apo personalitete të gjalla e të ndjera për rolin e tyre në shtet-ndërtimin e Republikës së Kosovës a për zhvillimin e Ferizajt, që sivjet po shënon 150-vjetorin e themelimit.

Në këto seanca, kuvendarët i kanë marrë gjithsej 46 vendime. Prej tyre, INPO i ka kategorizuar 17 sosh si “Të tjera”, pasuar me 13 vendime për “Dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të ponës komunale”, 8 vendime të fushës “Financiare”, 5 si “Plane e rregullore”, 2 si “Thirrje e rekomandime” dhe 1 “Rregullore”.

Kuvendi nuk ka marrë ndonjë vendim që vlerësohet a përceptohet nga shoqëria civile dhe opozita se ka ndikuar theksueshëm në jetën e përditshme të qytetarëve. Madje konsiderohet se Kuvendi është anashkaluar qëllimshëm nga pushteti ekzekutiv, duke u kthyer në makineri vote për aprovimin e politikave të tij, pa u dhënë llogari e raportuar hollësisht para kuvendarëve për mënyrën e hartimit të politikave publike e mënyrën e shpenzimit të parasë publike. Në Kuvend asnjëherë nuk është diksutuar rreth përmbushjes së objektivave zhvillimore komunale sipas Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025. Ekzekutivi i Komunës asnjëherë prej miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, nuk ka hartuar raportet vjetore ligjërish të obligueshme, të cilat pasqyrojnë progresin dhe sfidat e implementimit të këtij Plani. Anëtarët e Kuvendit nuk kanë insistuar asnjëherë që ekzekutivi të raportojë për këtë çështje në Kuvend.

Seancat e Kuvendit Komunal, edhe pse ligjërish është e obligueshme, nuk transmetohen drejtpërdrejt e as nuk janë të postuara në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt. Është shpërndarë në faqen e Komunës së Ferizajt në Facebook linku vetëm gjatë seancës së rregullt të fundshtatorit. Pushteti aktual, i cili ka 17 anëtarë Kuvendi nga radhët e PDK-së, 4 nga AAK-ja, 2 nga Nisma, 1 nga Ne Mundemi dhe 1 nga Lista e Ashkalinjve - në shumicën e rasteve ka edhe mbështetjen e kuvendarit të vetëm të AKR-së - ka përballë një opozitë që nuk po arrin ta rrokë vëmendjen e madhe të opinionit publik, megjithëse VV-ja ka 9 anëtarë, LDK-ja 4 dhe Reforma Demokratike 2 sosh. Koalicioni me shumicë bindëse në Kuvend ia ka mundësuar pushtetit që të zbatojë planet e veta pa përfillur shpesh edhe procedurat e detyrueshme ligjore, si njoftimet e nevojshme sipas afatit kohor ligjor, pa ua ofruar anëtarëve materialet e mbledhjeve në format elektronik apo fizik para disa seancave, pa shqyrtuar ankesat e kuvendarëve për miratim të procesverbaleve pavarësisht dyshimeve për ndryshim përmbajtësor të fjalimeve e diskutimeve të tyre, si dhe ka pasur raste kur i njëjti vendim është votuar në seanca të ndryshme për shkak të kontestimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit dhe e Pushtetit Lokal (MAPL).

Kuvendi Komunal i Ferizaj, seancën e parë sivjet e ka mbajtur pa e pasur të hartuar e të aprovuar Planin vjetor të punës. Kuvendi është fokusuar në aprovimin e planeve dhe rregulloreve që kryesisht janë obligime ligjore që vijnë prej MAPL-së. Dhënia për shfrytëzim afatgjatë e ngastrave dhe këmbimi i pronave komunale dominojnë vendimet e seancave të Kuvendit Komunal, pavarësisht dyshimeve të ngritura nga shoqëria civile e opozita për ligjshmërinë e kontestuar. Madje, opozita e akuzon Kuvendin Komunal se kështu po “legalizon uzurpimin” e pronave komunale.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, injoron shumicën e seancave të Kuvendit Komunal, duke marrë pjesë vetëm në ato që e ka obligim ligjor të raportojë, apo kur kërkohet mbështetja e kuvendarëve për aprovimin e dokumenteve të detyrueshme. Edhe shumica e drejtorëve mungojnë në shumicën e seancave, duke u paraqitur vetëm atëherë kur ka ndonjë pikë të rendit të ditës të lidhur direkt me drejtorinë e tyre. Shumica në Kuvendin Komunal të Ferizajt nuk i ka mbështetur kërkesat e opozitës që ndërmarrjet komunale t’u raportojnë kuvendarëve sipas afateve ligjore, por koalicioni në legjislativ vlerëson se raportimi duhet të bëhet në fund të vitit kur dominon fryma e festive e bie vëmendja për vendimet e debatet e qeverisjes lokale.

4. Metodologjia

Raporti është bazuar në të dhënat e mbledhura e të analizuar nga dokumentet zyrtare të vetë Kuvendit Komunal të Ferizajt dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa; nga vendimet dhe dokumentet e tjera të publikuara në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt; bazuar në analiza të dokumenteve të nivelit qendror që ka përgjegjësi ligjore e kushtetuese për monitorimin e punës dhe ligjshmërisë së qeverisjes lokale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale; bazuar në raportet e agjencive të pavarura të Kosovës, që monitorojnë dhe nxjerrin rekomandime për nivelin lokal, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies para qytetarëve të komunës; mbi bazën e monitorimit të punës së Kuvendit nga monitoruesit e INPO-s, të cilët rregullisht i përcjellin seancat dhe i analizojnë diskutimet dhe vendimet e tij; mbi bazën e raporteve të mediave lokale e qendrore- të shkruara dhe televizive – dhe bazuar në intervistat e zhvilluara me tre anëtarë të grupeve më të mëdha parlamentare nga pozita dhe opozita, si dhe me dy pjesëtarë të shoqërisë civile.

Përtej kësaj, ky raport ka analizuar edhe frymën e përgjithshme të debatit publik dhe të demokracisë lokale, sikur se kërkohet me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, por edhe me frymën e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, parimet e së cilës Kosova i ka integruar në infrastrukturën e saj ligjore të pushtetit lokal, meqë me këtë kartë kërkohet zbatimi i rregullave themelore të garantimit të pavarësisë financiare dhe administrative të autoriteteve lokale.

5. Thelbi i mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Ferizajt gjatë periudhës janar-shtator 2023

Sikurse u paralajmërua edhe më lart, INPO ka vendosur që të pasqyrojë përmbledhtas edhe debatet e kuvendarëve para, gjatë dhe pas marrjes së vendimeve, por edhe për raporte të ndryshme të kabinetit të kryetarit dhe drejtorive të ndryshme. Andaj, që gjykimi të jetë objektiv dhe gjithësecili lexues të mund të formulojë vetë një gjykim bazuar mbi fakte, para intervistave me anëtarët e Kuvendit dhe me pjesëtarë të shoqërisë civile dhe konkluzioneve e rekomandimeve për legjislativin dhe ekzekutivin, keni të përshkruara thelbësisht seancat e periudhës së monitoruar.

5.1. Kuvendi nis punën pa plan vjetor pune

Mbledhja e parë u mbajt më 31.01.2023. Në mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal të Ferizajt në vitin 2023 kanë marrë pjesë 39 anëtarë, përderisa vetëm Lumnije Morina kishte lajmëruar për mospjesëmarrje në seancë. Pos 15 pikave të rendit të ditës, kryeuesi i Kuvendit, Xhavit Zairqi, ka bërë të ditur se Komiteti për Politikë dhe Financa ishte pajtuar të shtohet edhe pika tjetër e rendit të ditës “Propozim – Vendim për plotësimndryshimin – Rishqyrtimin e vendimit Nr. 01.Nr. 148 të datës 30.11.2022 për taksë komunale”. Rendi i ditës është aprovuar me 39 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Në këtë mbledhje, Kuvendi Komunal ka aprovuar ndaras tri vendime për dhënie në shfrytëzim ose këmbim të pronës komunale. Është marrë vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesëve të ngastrave kadastrale 228-2 dhe 232-2 Z.K. Prelez i Muhaxherëve. Drejtori Sabri Murseli ka thënë se ngastrat ndodhen në zonën ku janë ndërtuar shtatë fabrika, që ishte bërë me shprehje të interesit, sipas ligjit, ku parashihen tri forma: nëpërmjet ankandit, shprehjes së interesit dhe raste të veçanta për dhënie në shfrytëzim. Komuna ka zgjedhur shprehjen e interesit me qëllim që bizneseve t’u vazhdohen kontratat. Nuk kishte asnjë biznes të ri e asnjë ankesë në proces.

Por Brahim Osmani, nga radhët e VV-së, ka folur për letrën e Kryesisë së Fshatit Prelez i Muhaxherëve, dërguar shëfave të grupeve parlamentare, nëpërmjet së cilës, u kërkohet kuvendarëve ta shtynin aprovimin e kësaj pike të rendit të ditës, sepse komuniteti ka “arsye për të besuar se ky propozim-vendim shkel një numër të neneve të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme”. Kryesia e fshatit shkruan në letër se nuk ka pasur dëgjim publik të organizuar nga Komuna, duke paralajmëruar se aprovimi i pastajmë do të përbënte shkelje të interesit të përgjithshëm. Osmani ka thënë gjithashtu se njoftimi publik është bërë si shprehje e interesit të përgjithshëm e jo si ankand publik, që përbën shkelje të procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për 99 vite. Propozim-vendimi është aprovuar në fund të diskutimit me votat e 34 anëtarëve të Kuvendit Komunal, përfshirë edhe pjesën më të madhe të anëtarëve të opozitës.

Është bërë këmbimi i ngastrave private në Bablak, 633-2 dhe 630-0 me pronën komunale 475-0, Z.k. Babush i Ri. Shqipe Jashari nga VV-ja ka thënë se anëtarëve të Kuvendit nuk u janë sjellë të gjitha materialet për këmbimin e ngastrave komunale dhe private me qëllim të zgjerimit të rrugës Bablak-Babush. Edhe Brahim Osmani nga VV-ja ka kërkuar, sikurse edhe herëve tjera, të silltet një projektor në sallën e Kuvendit dhe të sqarohen lokacionet e sakta të ngastrave, sepse kuvendarët po kanë vazhdimisht paqartësi. Në fund, propozimi-vendimi është aprovuar me 28 për, asnjë kundër dhe dy abstenime.

Po në të njëjtën seancë është vendosur për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për vendosje të kioskave, pjesët e ngastrave kadastrale 1745-1,1743-0, 708-1, 1876-0, 2816-1, 2787-3, 2025-0, 2160-0, 2806-2, 2136-2, 2501-0, 2527-2 Z.K. Pas pajtimit të pozitës dhe opozitës që koha e shfrytëzimit të ngastrave të jetë 5 e jo 15 vite, dhe me çmim fillestar prej 10 eurosh për metër katror, propozimi është aprovuar me 37 vota dhe asnjë kundër e asnjë abstenim.

Kuvendi Komunal ka aprovuar edhe propozimin për dy anëtarët e Komisionit për ndarjen e bursave, emrat për Komisionin e hartimit të planit të punës të KK-së, emrat e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Ka aprovuar edhe ndarjen e subvencioneve në Bujqësi.

Brahim Osmani, nga radhët e VV-së, ka akuzuar Kuvendin dhe Drejtorinë e Bujqësisë për mungesë të transparencës, duke kërkuar edhe raport për subvencionet e bujqësisë për vitin e kaluar. Ka thënë se ka pasur bujq që u është refuzuar kërkesa nëpërmjet një mesazhi telefonik. Drejtori i Bujqësisë, Burim Bajrami, ka thënë se të dhënat i ka Komisioni i veçantë, i themeluar nga kabineti i kryetarit të Komunës, për kompensimin e dëmeve materialeve nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi. Megjithatë, në fund të gjithë 39 anëtarët e Kuvendit kanë aprovuar planin për subvencione.

Kuvendi Komunal në të njëjtën seancë ka aprovuar nxjerrjen për diskutim publik Projekt-planin e Komunës për menaxhimin e mbeturinave, por ka aprovuar pa debat plotësimin e vendimit 01. Nr. 160 për hapjen e shqyrtimit publik për Draft-projektin e Hartës Zonale të Komunës së Ferizajt 2022-2030 dhe ka marrë vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01. 148 të datës 30.11.2022 për taksa komunale, që gjithashtu ka kaluar pa diskutim në seancë.

Vendimet:

1. Aprovohet propozimi për dy anëtarët e Komisionit për ndarjen e bursave
2. Aprovohen emrat për Komisionin e hartimit të planit të punës të KK-së
3. Aprovohen emrat e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
4. Ndarja e subvencioneve në Bujqësi
5. Hedhja në diskutim publik e Projekt-planit të Komunës për menaxhimin e mbeturinave

6. Këmbimi i ngastrave private në Bablak, 633-2 dhe 630-0 me pronën komunale 475-0, Z.k. Babush i Ri
7. Plotësimi i vendimit 01. Nr. 160 për hapjen e shqyrtimit publik për Draft-projektin e Hartës Zonale të komunës së Ferizajt 2022-2030
8. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesëve të ngastrave kadastrale 228-2 dhe 232-2 Z.K. Preleze i Muhaxherëve
9. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për vendosje të kioskave, pjesët e ngastrave kadastrale 1745-1, 1743-0, 708-1, 1876-0, 2816-1, 2787-3, 2025-0, 2160-0, 2806-2, 2136-2, 2501-0, 2527-2 Z.K
10. Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01. 148 të datës 30.11.2022 për taksa komunale

5.2. Përplasja për (mos)faljen e tatimit në pronë

Mbledhja e parë e jashtëzakonshme u mbajt më 03.02.2023. Kuvendi Komunal ka mbajtur mbledhjen të thirrur nga anëtarët e VV-së, me pikën e vetme të rendit të ditës: Falja e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e komunës tonë për vitin 2023.

Por gjatë seancës, grupet parlamentare janë pajtuar që Kuvendi Komunal t'i rekomandojë "Ministrisë së Financave t'i lirojë qytetarët e Ferizajt nga tatimi në pronë për vitin 2023 në vlerë prej 100 eurosh, ose të pezullojë aplikimin e zbatimit të vlerësimit të pronave të paluajtshme të faturave të vitit 2023 dhe rivlerësimin e tyre si para vitit 2023", edhe pse në Ligjin për vetëqeverisje lokale në nenin 44 – Takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës -thuhet shprehimisht në paragrafin 44.3 se "pikat caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes".

Vendimi:

Kuvendi Komunal i rekomandon Ministrisë së Financave t'i lirojë qytetarët e Ferizajt nga tatimi në pronë për vitin 2023 në vlerë prej 100 eurosh, ose të pezullojë aplikimin e zbatimit të vlerësimit të pronave të paluajtshme të faturave të vitit 2023 dhe rivlerësimin e tyre si para vitit 2023.

5.3. Edhe mbledhja e dytë nisi pa plan vjetor pune

Mbledhja e dytë e rregullt u mbajt më 28.02.2023. Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë 39 anëtarë. Administrata e Kuvendit nuk ishte paralajmëruar për mungesë të pjesëmarrjes në seancë. Pikat e rendit të ditës u aprovuan me 39 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kuvendi Komunal ka aprovuar Planin vjetor të punës, porse Brahim Osmani nga VV-ja, anëtar i Komisionit për hartimin e Planit, ka thënë para kuvendarëve se anëtarët e Komisionit nuk ishin mbledhur asnjëherë dhe se plani "është copy-paste i planit të vitit të kaluar". Ai ka thënë se kryetari i Komisionit, Hyzri Korenica, ka kërkuar rekomandimet nëpërmjet postës elektronike vetëm tri ditë para afatit për dorëzimin e tyre. Arian Imeri, shef i grupit parlamentar të shumicës, ka thënë se anëtarët e Komisionit nuk e kanë kryer punën si duhet. Flamur Istrefi, shef i grupit parlamentar të LDK-së, ka mbështetur kërkesën e Osmanit që miratimi i planit të shtyhet, mirëpo kryesuesi

Xhavit Zariqi e ka hedhur në votim. Plani vjetor i punës i Kuvendit Komunal është aprovuar me 24 vota për, 9 kundër dhe 7 abstenime.

Po në këtë seancë, të tretën deri atëherë e të dytën të rregullt, Kuvendi Komunal pa asnjë diskutim, aprovoi propozim-vendimin për datat e mbajtjes së seancave të rregullta për çdo muaj. Paradoksalisht është votuar edhe për 31 janarin dhe 28 shkurtin si data për mbajtjen e seancave që tashmë ishin mbajtur, ose po mbaheshin. Me 38 vota për, asnjë kundër e asnjë abstenim është aprovuar propozim-vendimi.

Është aprovuar me 39 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim propozim-vendimi për nxjerrjen në diskutim publik të Projekt-programit trevjeçar të banimit 2023-2026. Kuvendarët me 23 vota kundër (shumica të opzites), 10 për dhe 2 abstenime e kanë hedhur poshtë draft-statutin për Qendrën e Mjekësisë Familjare të Ferizajt me arsyetimin se nuk janë marrë parasysh kërkesat e tyre dhe se në statutin e propozuar ka elemente diskriminimi, sikur neni 14 që ua jep të drejtën e konkurimit për drejtor vetëm mjekëve të mjekësisë familjare. Në këtë seancë është aprovuar edhe themelimi i Komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të ngastrave komunale për kioska. Janë emëruar edhe anëtarët e Komitetit Konsultativ për shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara.

Vendimet:

1. Miratimi i Planit Vjetor të Punës së KK-së së Ferizajt për 2023
2. Vendim për përcaktimin e orarit të mbledhjeve të punës të KK-së së Ferizajt
3. Vendim për nxjerrjen në Konsultim publik të projekt-programit 3-vjeçar të banimit 2023-2025
4. Hidhet poshtë draft-statuti për QKMF-në e Ferizajt
5. Vendim për formimin e Komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pjesëve të ngastrave kadastrale komunale për kioska
6. Vendim për emërimin e anëtarëve për Komitet Konsultativ për shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara

5.4. Inatet e nivelit qendror reflektohen në atë lokal

Mbledhja e tretë e rregullt u mbajt më 31.03.2023. Në mbledhjen e fundmarsit, Kuvendi Komunal i Ferizajt morën pjesë 39 anëtarë dhe asnjë nuk kishte njoftuar administratën për mungesë të pjesëmarrjes. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, në hyrje të pjesës së parë të raportit të tij të punës për vitin 2022, u ka thënë kuvendarëve se “burokracitë e nivelit qendror” kanë ngadalësuar ritmin e realizimit të projekteve komunale. Ai ka folur për “vrull” të punëve që, sipas tij, po e transformojnë qytetin dhe rrethinën, megjithëse në terren projektet janë stërzgatur për shkak të mungesës së planifikimit të qartë e pengesave që mund të shmangeshin para fillimit të realizimit të projekteve që kanë penguar qarkullimin e trafikut, sikur se ndodhi me rikonstruktimin e gjysmës së rrugës “Ahmet Kaçiku”, që ende nuk ka përfunduar plotësisht.

Flamur Istrefi, shef i grupit parlamentar të LDK-së, ka thënë se kryetari prezantoi “vetëm njërën anë të medaljes”, duke theksuar se Aliu u krenua me disa rrethrotullime të vogla e me projekte që nuk bëjnë ndryshim në jetën e qytetarëve ferizajas. Ka thënë gjithashtu se kryetari kishte premtuar mandat të dominuar nga politikat e gjelbra, porse asnjë projekt kapital në këtë fushë nuk e ka realizuar gjatë vitit 2022. I është referuar gjithashtu një raporti të policisë që theksonte se gjatë aksioneve policore rreth shkollave janë gjetur 5 pistoleta, 2 armë gjysmë-automatike, rreth 20 thika dhe boksa të hekurit.

Adnan Selmani, shef i grupit parlamentar të VV-së, ka thënë se kryetari ka dështuar t’i realizojë me kohë projektet kapitale dhe se po i bart mjetet vetanake nga viti në vit për shkak të neglizhencës.

Arian Imeri, shef i grupit parlamentar të shumicës, ka thënë se raporti paraqet punët e suksesshme që janë kryer nga ekzekutivi, duke ia vënë në pah opozitës ngritjen e të hyrave vetanake prej 32 për qind krahasuar me vitin paraprak. E ka akuzuar nivelin qendror se për shkak se Ferizaj qeveriset nga PDK-ja dhe aleatët e saj në koalicion, Qeveria e VV-së nuk po e mbështet për motive politike. Në këtë mbledhje kanë prezantuar dhe debatuar drejtorët Afrim Llabjani, Arbër Bytyçi, Xhemile Murati Shabani, Kemajl Emini dhe Arben Halili. Llabjani i ka thënë Istrefit se armët janë gjetur jashtë oborreve të shkollave.

Kuvendi Komunal ka miratuar gjithashtu Rregulloren për institucionet edukativo-arsimore të arsimit parauniversitar të komunës së Ferizajt. Shumica e kuvendarëve ka vendosur për nxjerrje në diskutim publik të Projekt-planit të integritetit të viteve 2023-2027. Kuvendi ka miratuar planin komunal për menaxhimin e mbeturinave për vitet 2023-2027. Ka aprovuar propozim-vendimin për miratimin e nismës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit të Ferizajt dhe të regjionit të Gjilanit në fushën e sektorit të menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Po në këtë senacë, Kuvendi ka aprovuar bartjen e të hyrave vetanake nga vitit 2022 në vitin 2023. Ka rivotuar emrat e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Komunitete dhe shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara për shkak të gabimeve “tekniko-procedurale”, sikur se i ka vlerësuar MAPL-ja. Anëtarja Arbnora Salihu u ka bërë thirrje të gjithë drejtorëve dhe kolegëve kuvendarë që të marrin pjesë në marshin për drejtësi kundër gjykimit të ish-liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë.

Vendimet:

- 1 Miratimi i Rregullores për institucionet edukativo-arsimore të arsimit parauniversitar të Komunës së Ferizajt
- 2 Miratimi për nxjerrje në diskutim publik të Projekt-planit të integritetit të viteve 2023-2027
- 3 Miratimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave për vitet 2023-2027

- 4 Miratimi i bartjes së të hyrave vetanake nga vitit 2022 në vitin 2023
- 5 Riuvotim i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Komunitete dhe Shërbime Sociale për Persona me Aftësi të Kufizuara për shkak të gabimeve “tekniko-procedurale” nga MAPL

5.5. Kontestimi i procesverbalit

Mbledhja e katërt e rregullt u mbajt më 28.04.2023. Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Ferizajt, Xhavit Zariqi, ka konfirmuar në fillim të seancës se të gjithë anëtarët ishin të pranishëm në sallë. Megjithatë, ai nuk e ka marrë parasysh kërkesën e shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Flamur Istrefi, që të rishikohet përmbajtja e procesverbalit të seancës së kaluar të Kuvendit Komunal, sidomos pjesa e debateve pas raportimit të kryetarit për shkak të ankesave të disa kuvendarëve se nuk ishin përfshirë pjesë të rëndësishme të deklarimeve të tyre në foltore.

Mirëpo kryesuesi Zariqi nuk e ka përfillur kërkesën e tij dhe e ka hedhur në votim procesverbalin e seancës paraprake, që është aprovuar nga shumica parlamentare. Në këtë seancë, është votuar propozimi për nxjerrje në diskutim publik i Draft-planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe rintegrimim të huajve në komunën e Ferizajt për vitet 2023-2025. Debat mes shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Flamur Istrefi, drejtorit të Gjeodezisë së dhe Kadastrit, Sabri Murseli, dhe anëtarëve të shumicës parlamentare, ka ngjallur propozimi për këmbimin (Formimi, sikur shkruan në dokumentin komunal) e ngastrës kadastrale private 3148-0 me pjesën kadastrale komunale 2769-0 për shkak të zgjerimit të rrugës në qytet.

Istrefi ka ngritur dyshime për qëllimin dhe mënyrën e këmbimit, duke pasur parasysh se Komunës së Ferizajt edhe ashtu i mungojnë hapësirat e gjera publike për krijimin e parqeve dhe për nevoja të ndryshme komunale. Në fund propozimi është votuar me 33 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime. Është aprovuar edhe propozim-vendimi për Formimin e ngastrës kadastrale 1750-O dhe 1049-O në zonën kadastrale të Neredimes së Ulët në pjesën e ngastrës kadastrale 1111-O dhe 1738-O, zona kadastrale Neredime e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt. Drejtori Sabri Murseli ka thënë se kërkesa ka ardhur prej palës, e jo për shkak të interesit të përgjithshëm, pasi “pala në atë pjesë e ka ndërtuar shtëpinë”.

Murseli ka pasur diskutime edhe me kryesuesin për shkak të mënyrës së paqartë të zgjidhjes së çështjes së diferencës së sipërfaqes së pronave për këmbim. Drejtori Murseli ka thënë se në fund “paguhet diferenca” sipas vlerësimit të sipërfaqeve të këmbyera. Para se të votohej propozimi që “me u ba ndërrimi me pronë”, Istrefi ka thënë se kështu po bëhet “legalizimi i uzurpimeve”. 27 kuvendarë mbështetën propozimin e drejtorit Murseli, derisa 6 ishin kundër e 2 abstenuan. Në “Të ndryshme”, anëtarja e Kuvendit nga radhët e PDK-së, Mimoza Pajaziti, i ka kërkuar drejtorit të Shërbimeve Publike, i cili nuk ishte i pranishëm në seancë, që të merrte masa pas ankesave të shumta të qytetarëve për vjedhjen e kapakëve të pusetave.

Vendimet:

- 1 Miratimi i propozimit për nxjerrje në diskutim publik i Draft-planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe rintegrimin e të huajve në komunën e Ferizajt për vitet 2023-2025
- 2 Këmbimi(Formimi) i ngastrës kadastrale private 3148-0 me pjesën kadastrale komunale 2769-0
- 3 Vendim për ndërrimin e parcelës kadastrale private 3148-0 me parcelën kadastrale komunale 2769-0

5.6. Ndërmarrjet komunale s'kanë kujt t'i raportojnë

Mbledhja e pestë e rregullt u mbajt më 31.05.2023. Menjëherë pas hapjes së seancës dhe leximit të pikave të rendit të ditës, drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Arben Halili, ka kërkuar që të shtyhen propozimet për ndryshimin e vendimeve për shërbimeve të varrimit për shkak se pas konsultimeve me Bashkësinë Islame dhe drejtoritë përgjegjëse është arritur dakordim që propozimet për ndryshimin e vendimeve të ripërgatiten për seancën e radhës. Kërkesa është aprovuar me 24 vota për, asnjë kundër e asnjë abstenim.

Gjatë diskutimit për miratimin e Programit trevjeçar të banimit 2023-2025, shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Flamur Istrefi, ka treguar se që në analizë të këtij plani tregohet se në qytetin e Ferizajt janë përkrahur familjet nga ndërtuesit e ndërtesave shumëbanesore, duke ndarë nga dy apo tri njësi banesore brenda ndërtesave, ku për kompensim të tokës komunale, kanë përfituar njësi banimi të cilat janë dhënë si banesa sociale. Komuna i ka përzgjedhur përfituesit, por që nuk po paguajnë qira sikur edhe të vendosurit në banesa sociale, ka shtuar ai. Por me 23 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim ka kaluar propozim-planin.

Drejtoresha e Financave, Sebahate Sadiku-Ajeti, ka bërë prezantimin e raportit financiar janar-mars 2023, duke theksuar se të hyrat vetanake për këtë periudhë krahasuar me të vitit paraprak kanë shënuar ngritje prej 55.89 për qind. Deri në fund të marsit, Komuna e Ferizajt shpenzoi 20.4 për qind të buxhetit.

Anëtarja e LDK-së, Verona Isaki, ka thënë se të dhënat që u janë dorëzuar kuvendarëve nuk përputhen me ato në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt. Ka thënë gjithashtu se ka shpërputhje deri në 100 mijë euro në tabelat e ndryshme për të njëjtën drejtori. Ejup Delolli, nga PDK-ja në pushtet, ka shprehur shqetësimin se bazuar në raport, shuma për paga dhe mëditje në fund të vitit 2023 do të jetë për 2.7 milionë më e lartë. Ka shprehur drojën se Komuna do të përballet me përmbaruesit si në të kaluarën. Drejtoresha e Financave ka shpjeguar se diferenca financiare do të mbulohet me ligjin e ri të pagave.

Në pikën “Të ndryshme”, Brahim Osmani, nga VV-ja, ka thënë se bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal, ndërmarrjet publike do të duhej të raportonin në mars, apo prill. Ka shprehur

habinë se pse nuk kanë raportuar ende. Hatixhe Bungu, nga AAK, Besimi Haziri nga LDK e Ibrahim Osmani nga VV, kanë pasur pyetje për drejtorët, por që nuk ishin të pranishëm.

Vendimet:

1. Vendimi për miratimin e Programit trevjeçar të banimit 2023-2025
2. Shtyhen propozimet për ndryshimin e vendimeve për shërbimet e varrimit

5.7. KASH-i i mirë, KASH-i i keq

Mbledhja e gjashtë e rregullt u mbajt më 27.06.2023. Seanca ka nisur me ngritjen e kërkesës së shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për heqjen e pikave 4 dhe 5 nga rendi i ditës – Propozim-vendimi për miratimin e Planit të Komunës për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Riintegrimin e të Huajve në Komunën e Ferizajt 2023-2025.

Adnan Selmani ka shtruar kërkesën duke u bazuar në telashet që anëtarët e Kuvendit Komunal kanë pasur për t'i hapur materialet e dërguara me postë elektronike nga Administrata e Kuvendit Komunal. Kësaj kërkesë i është bashkuar edhe shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Flamur Istrefi, i cili ka thënë se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kishte kërkuar edhe heqjen e pikës së rendit të ditës për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit, Xhavit Zariqi, ka thënë se materialet kanë qenë publike dhe se vetëm një pjesë e kuvendarëve nuk kanë arritur ta hapnin materialin në postë elektronike, duke i fajësuar ata për telashet eventuale që mund t'i kenë në pajisjet e tyre teknologjike. Edhe anëtarja e Kuvendit, Yllkë Neziri, ka kërkuar heqjen e pikave 4 dhe 5 për të njëjtat arsye. Madje ka thënë se materiali nuk u është dorëzuar anëtarëve as fizikisht.

Në fund Zariqi e ka hedhur në votim propozimin e opozitës, por shumica, apo 21 anëtarë, votuan kundër heqjes së pikave të rendit të ditës. Pakize Bujani, nga Lista e Ashkanlinjve, ka thënë se strategjitë edhe pasi po aprovohen në Kuvend, nuk është se po zbatohen, duke përmendur se ka raste kur qytetarëve të riatdhesuar nuk u është siguruar strehim nga Komuna e Ferizajt. Në fund, 22 anëtarë kanë votuar për, 13 kundër dhe 1 ka abstenuar.

Edhe pika e pestë ka kaluar pavarësisht kërkesave e ankesave të opozitës. Madje procesverbali, që jozyrtarisht e kishte siguruar INPO, ende nuk ishte publikuar në uebfaqen e Komunës së Ferizajt në fund të shtatorit. Planin e Integritetit 2023-2027 e kanë votuar 17 anëtarë, 13 ishin kundër dhe 1 abstenoj.

Kryesuesi Zariqi ia ka dhënë fjalën kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu, që para diskutimit e hedhjes në votim, të shpallë përmbledhtas Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026, që është një prej dokumenteve më të rëndësishme dhe strategjike të qeverisjes lokale për planet buxhetore të zhvillimit të qytetit dhe rrethinës. Kryetari Aliu ka treguar se në KASH janë

planifikuar mbi 12 milionë euro investime kapitale, derisa në vitin 2025, 12 milionë e 600 mijë e më 2026 mbi 13 milionë euro. Ka thënë se prioritet do të jetë gjelbrimi, por që në sheshet dhe rrugët kryesore të qendrës dhe të atyre që lidhin qytetin me periferitë e rrugët magjistrale, nuk janë mbjellë fare drunj në vitet e fundit.

Opozita e ka akuzuar kryetarin se ka paraqitur “premtime të rrejshme” dhe se KASH-i nuk reflekton kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Adnan Selmani nga LVV-ja ka thënë se ekzkeutivi po “i ik përgjegjësisë”. Flamur Istrefi nga LDK-ja ka shprehur drojën se bazuar në përvojën e kaluar të ekzkeutiviti, projektet e KASH-it nuk do të realizohen dhe se do të barten vit pas viti, “sikur se është rasti i fundit kur japin dhjetëra mija euro në muaj për letër të bardhë e qindra mija euro për shtypje të materialeve për nevojat e Komunës dhe përsëri nuk kemi material për seancë”.

Ngërkaq Brahim Osmani nga LVV-ja ka spikatur se kryetari ia ka rritur zyrës së tij buxhetin për 46 mijë euro. Edhe bashkëpartiakja e tij, Yllka Neziri, ka thënë se 50 për qind e projekteve po shtyhen nga viti në vit. Elbasan Osmani nga PDK e ka mbrojtur draftin e KASH-it, duke e vlerësuar si të suksesshme qeverisjen e pushtetit aktual. Bashkëpartiake i tij, Ejup Delolli, ka shprehur shqetësimin se “krejt lumenjtë janë mbeturina e katastrofa është gjendja (dhe se), v.j.) askush nuk merret me këtë gjendje”. Sadat Ismajli nga PDK-ja ka nxitur reagimin e opozitës kur ka kërkuar “që të mos flitet për Komogllavë” prej nga vjen ai, megjithëse sipas frymës së Kushtetutës së Kosovës, Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për zgjedhjet lokale, anëtarët e Kuvendit i përfaqësojnë qytetarët e të gjithë komunës pa asnjë dallimi fshati, qyteti a rajoni.

Kryesuesi i Kuvendit, Xhavit Zariqi, ka thënë në fund se “është turp për këtë Kuvend çfarë debati bën” për KASH-in, duke akuzuar opozitën sesi asnjëri prej tyre “nuk doli me thanë: mirë që janë këto projekte, por unë kam një propozim, një projekt me prioritet për këtë çështje. Vërejtje pa lidhje që s’ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore...”

Kryetari Aliu ka replikuar me një fjalim të përgjithshëm, me elemente demagogjike, duke e tjetërsuar thelbin e debatit me shprehje si...”vetëm dua të përmend faktin se Ferizaj ka një traditë të debatit të mirë dhe duhet ta ruajmë si diçka që është një lloj ADN-je e Ferizajt...”

Në fund, KASH-i është aprovuar me 23 vota për, 8 kundër dhe asnjë abstenim.

Replika ka pasur edhe për propozim-vendimin për ndarjen e ngastrës për ndërtimin e një çerdhe në fshatin Dardani, si projekt i Ministrisë së Arsimit. Debati është zhvilluar për shkak të dallimeve politike të nivelit qendror, që gjithnjë reflektojnë në politikat, diskutimet dhe vendimet lokale. 30 anëtarë votuan për dhe asnjë nuk votoi kundër apo të abstenonte.

Në fund, kryetari i shoqatës “Jerzerci”, Fadil Sejdiu, duke u bazuar në petitionin e qytetarëve për t’iu drejtuar Kuvendit Komunal, ka paraqitur kronologjikisht pse kuvendarët duhet të mbështesin kërkesën e tij që Kuvendi t’u bëjë thirrje organeve përgjegjëse që të zbatojnë vendimet lidhur me

pretendimet e banorëve të Jezercit, që thonë se regjimi serb ua kishte marrë kundërligjshëm dhe padrejtësisht tokat e tyre për t'ia dhënë ndërmarrjes së atëhershme për menaxhimin e pyjeve publike. Thirrja e tij është mbështetur nga të gjithë, megjithëse ka mbetur vetëm në nivel rekomandimi. Por debat të ashpër ka pasur ndërmjet z.Sejdiu dhe drejtorit të Gjeodezisë dhe Kadastrit, Sabri Murseli, lidhur me ligjshmërinë e vendimeve dhe përgjegjësitë e autorizimeve komunale. Në “Të Ndryshme”, Sylejmani Metushi nga PDK-ja ka ngritur shqetësimin se nuk po respektohet orari i farmacive për kujdetsari natën.

Vendimet:

1. Miratimi i Planit të Komunës për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Riintegrimin e të Huajve në Komunën e Ferizajt 2023-2025
2. Miratimi i Planit të Integritetit 2023-2027
3. Miratimi i Draft-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KAB) 2024-2026
4. Ndarja e ngastrës për ndërtimin e një çerdhe në fshatin Dardani
5. Thirrje organeve përgjegjëse për zbatimin e vendimit lidhur me peticionin e shoqatës “Jezerci” për tokat e kontestuara

5.8. Seanca që zgjati dy ditë për rreth 60 mijë euro subvencion

Mbledhja e shtatë e rregullt u mbajt më 31.07 dhe më 01.08.2023. Është mbledhja e vetme e këtij legjislativi që ka zgjatur dy ditë për shkak se pushteti në ditën e parë të seancës nuk ia kishte dalë t'i bindte as partnerët e koalicionit lokal për të qëndruar në sallë për të mbështetur propozim-vendimin për mbështetjen e ndërmarrjes “Stacioni i Autobusëve” me rreth 60 mijë euro për ta kompensuar një ish-punëtor, që sipas vendimit të gjykatës, ishte larguar kundërligjshëm nga puna më 2016.

Drejtoresha e Financave, Sebahate Sadiku-Ajeti, ka thënë se ndërmarrja komunale nuk ka mjete financiare për ta kompensuar Femi Hajrullahun. Seanca ka vazhduar të nesërmen, ku ka qëndruar edhe opozita. Amir Rexhepi nga VV-ja ka kërkuar që Kuvendi ta shkarkojë Bordin e Stacionit të Autobusëve me pretendimin se Bordi kishte vendosur ta kthente në punë si ujudi për t'u tërhequr nga procesi gjyqësor. Rexhepi ka thënë se bazuar me këtë qasje mund të vijë edhe kërkesa të ngjashme prej atyre që po ndjekin rrugën ligjore.

Ibrahim Hyseni, nga AKR-ja, ka ftuar prokurorinë që të hetojë jo vetëm këtë rast keqmenaxhimi. Arian Imeri, nga koalicioni parlamentar lokal, ka akuzuar për sjellje “të turpshme” opozitën që një ditë më parë u largua nga seanca që t'ia pamundësonte marrjen e vendimit Kuvendit Komunal.

Flamur Istrefi nga LDK-ja ka thënë se seanca nuk ishte lëshuar për shkak të pikës së mbështetjes financiare Stacionit të Autobusëve, por si solidarizim me kuvendarin Brahim Osmani, pasi që gjatë fjalimit të tij një ditë më parë, në seancë ishin vetëm 14 anëtarë Kuvendi. Pushteti siguroi

mbështetjen e shumicës së kuvendarëve për subvencionimin e Stacionit të Autobusëve me mbi 59 mijë euro.

Osmani po fliste për gjetjet e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditorit (ZKA) për pasqyrat financiare të Komunës së Ferizajt më 2022. Derisa po fliste u larguan edhe disa kuvendarë bashkëpartiakë. Osmani ka thënë se raporti “tregon më sëmiri për paaftësinë, shkeljet dhe abuzimet që i kanë bërë”. Osmani ka thënë se kryetari Aliu do të duhej të ishte në seancë për t’u përballur me kuvendarët dhe të dhënat e raportit të ZKA-së.

Edhe Flamur Istrefi, shef i grupit parlamentar të LDK-së, ka thënë se raporti ka konfirmuar shqetësimet e ngritura nga partia e tij. Istrefi ka thënë se pushteti komunal ka favorizuar “operatorë ekonomikë të afërt me pushtetin dhe ka diskriminuar operatorët e tjerë ekonomikë”. Gjithashtu ka thënë se po anashkalohet Kuvendi Komunal si organ të cilit duhet t’i japë llogari ekzekutivi.

Lulzim Abazi, nga PDK-ja, ka mbrojtur qeverisjen e kryetarit Aliu, duke theksuar se në këtë raport “gjejmë përpjekjen e ekzekutivit për të bërë planifikimin për të bërë shpenzimin e duhur të parasë publike”. Në të njëjtën seancë, por një ditë më parë pas shumë debateve u aprovuan edhe dy ndryshim-vendimet për shërbimin e varrimit për qytetarët e komunës së Ferizajt: Ndryshimi i vendimit për shumën e shërbimeve të varrimit, të kryera nga Bashkësia Islame – ngrihet nga 250 në 320 euro – për qytetarët e komunës së Ferizajt dhe vendimi për vendosjen e gurëve të varreve me përmasa 80 me 60cm me mbishkrimin e të dhënave varreve në bllokun e ri të varrezave të qytetit në Fshatin e Vjetër – me shumë prej 130 eurosh për gurë për Bashkësinë Islame.

Është aprovuar edhe kërkesa e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër për këmbimin e ngastrës kadastrale private 3654-2 Z.K. në Jezerc me parcelën kadastrale komunale 3485-0 në Jeze, si dhe për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 Z.K., Babush i Ri.

Vendimet:

1. Miratohet ndryshimi i vendimit për shumën e shërbimeve të varrimit, të kryera nga Bashkësia Islame – ngrihet nga 250 në 320 euro – për qytetarët e komunës së Ferizajt
2. Miratohet vendimi për vendosjen e gurëve të varreve me përmasa 80 me 60cm me mbishkrimin e të dhënave në bllokun e ri të varrezave të qytetit në Fshatin e Vjetër – me shumë prej 130 eurosh për gurë për Bashkësinë Islame
3. Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale private 3654-2 Z.K. në Jezerc me parcelën kadastrale komunale 3485-0 në Jezerc
4. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 Z.K., Babush i Ri

5. Vendimi për subvencimin e ndërmarrjes së Stacionit të Autobusit me mbi 59 mijë euro për ta kompensuar ish-drejtorin e shkarkuar, Femi Hajrullahu, nga ish-kryetari Muharrem Svarqa. Gjykata e ka kthyer Hajrullahun në punë.

5.9. Sherri për tokën e kontestuar

Mbledhja e tetë e rregullt, mbajtur më 31. 08.2023. Pretendimi për devijimin e vijave kuzifuese të një parcele në fshatin Zaskok – ngritur në “Të Ndryshme” nga kuvendari Besim Haziri i LDK-së-ka marrë vëmendjen më të madhe të kuvendarëve, mediave dhe monitoruesve të punës së Kuvendit Komunal të Ferizajt. Drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrit, Sabri Murseli, ka prezantuar dokumentacion me të cilin pretendon se parcela ishte këmbyer në kohën e regjimit serb për nevoja të sistemit të atëhershëm publik të ujësjellësit.

Megjithatë, Haziri ka kërkuar materiale zyrtare që dëshmojnë se si ishte gjendja para një viti pasi banorët dyshojnë se qëllimshëm janë ndërruar kufijtë e parcelës në dëm të pronës publike nga pronari privat. Anëtari i Kuvendit, Ejup Delolli, nga radhët e PDK-së në pushtet, e që njëherësh vjen nga Zaskoku, ka konfirmuar se kuvendarëve nuk u janë ofruar dokumente zyrtare nga drejtoria e Murselit, dhe ka kërkuar përgjigje zyrtare se a janë ndryshuar skicat.

Debati ka eskaluar me akuza për shpifje e pretendime për ngritjen e rastit para organeve të drejtësisë. Dyshime ka ngritur edhe vetë kryesuesi i Kuvendit Komunal, Xhavit Zariqi, derisa pas presionit të madh, drejtori Murseli ka paraqitur një dokument, të prezantuar si të vitit 2008. Ka thënë se Drejtoria e tij do ta verifikojë nëse gjendja në terren përkon me atë në dokumente zyrtare. Është ankuar se nuk ka pasur informacione, edhe pse ka disa seanca që kjo çështje është ngritur nga opozita. “Këtu diçka është përzi, kush e ka përzi, unë nuk e di”, ka thënë shprehimisht Zariqi, duke i kërkuar Murselit që t’ua saqrojë qytetarëve gjendjen. Kryesuesi i është drejtuar Murselit: “Drejtor i ki krejt mundësitë me saktësu dhe me verifiku se i ki kejt mundësitë. Nuk mundesh me thanë nuk e kam skicën”.

Debat ka ngjallur edhe shkëputja e kontratës nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe OJQ-së, “Islamic Relief Kosova”, për punësimin e 40 punëtorëve shëndetësorë. Drejtori Kemajl Emini ka konfirmuar se pas ankesave, IRK-ja ka përsëritur konkursin e parë, por edhe pas konkursit të dytë ishte kërkuar përsëritja për shkak të tri ankesave. Por, Komuna kishte kundërshtuar këtë dhe IRK-ja kishte marrë përsipër organizimin e rekrutimit të stafit, porse pas shembjes së QMF-së afër rrugës “Rexhep Bislimi”, Komuna kishte kërkuar që projekti të ndryshohej dhe IRK-ja të investonte në një projekt në kuadër të investimeve kapitale, por IRK-ja ndau mendjen ta shkëpuste kontratën.

Kuvendari i VV-së, Brahim Osmani, ka thënë se IRK-së i ishte bërë presion që me konkurs të pranoheshin edhe familjarëve të kryetarëve të komunave tjera. Osmani ka ngritur dyshimin se u janë zbritur pikët disa kandidatëve dhe se të tjerëve u janë ngritur.

Arian Imeri, nga koalicioni në Kuvend, i është kundërpërgjigjur kolegut Osmani me pretendimin se “nuk tha asgjë” dhe se nuk ofroi asnjë dëshmi për arsyet e shkëputjes së kontratës nga IRK-ja. Në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu.

Kuvendi Komunal në këtë seancë ka aprovuar procesverbalin e seancës së shtatë. Kryesuesi i Kuvendit, Xhavit Zariqi, e ka hedhur në votim për vënie në diskutim publik Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034 pasi nuk ka pasur kërkesa për diskutim nga kuvendarët. Pastaj është votuar edhe propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim afashkurtër të pjesës së ngastrës kadastrale 629-I Z.K. në Babush të Ri.

Në këtë pikë, opozita ka përsëritur shqetësimin se nuk janë të qarta materialet – sidomos skicat – që sillen në Kuvend për këto ngastra. Ende nuk është përmbushur kërkesa e disa kuvendarëve që këto propozim-vendime të shoqërohen me pamje të qarta dhe me vendosje të një monitori në sallën e Kuvendit.

Është aprovuar edhe propozim-vendimi për plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01.Nr. 110 të 30 shtatorit 2019. Është aprovuar edhe propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesëve të ngastrave 1327-0 Z.K. Zllatar, 1683 ZK. Komogllavë, 753 Sazli, 416-0 Z.K Lloshkobare, 690-3 Z.K. Talinoc i Jerlive, 1046-I Z.K. Prelez i Jerlive, 1300-0 Z.K. Nerodime e Ulët dhe 1588-0 Z.K. Nerdoime e Epërme. Është aprovuar edhe propozim-vendimi për shpallje Interes i përgjithshëm i pjesëve të ngastrave kadastrale, 705 dhe 705-4 Z.K, Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Llabjani, ka raportuar për përgatitjen para fillimit të vitit të ri shkollor, duke e pranuar se në shkollën e fshatit Rahovicë ende po kryheshin punimet e renovimit të shkollës. Anëtari i Kuvendit, Brahim Osmani, nga VV, ka vënë në dyshim mundësinë e fillimit të ri shkollor në objektin që ende nuk kishte dyer e dritare. Në këtë senacë nuk kaloi propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje për faljen e tatimit në pronë nga Komuna deri në shumën prej 100 eurosh, pasi Gjykata Kushtetuese e ka pezulluar ligjin e Kuvendit të Kosovës që u rekomandon Kuvendeve Komunale t’ua falin borxhin qytetarëve.

Vendimet:

1. Vendimi për nxjerrje në diskutim publik të Strategjisë për zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034.
2. Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pjesës së ngastrës kadastrale 629-I Z.K. Babush i Ri.
3. Vendim për plotësimndryshimin e vendimit me Nr. 01. Nr. 110 të datës 30.09.2019.

4. Vendim për dhënien afatgjatë të pjesëve të ngastrave kadastrale 1327-0 Z.K.Zllatar, 1683-1 Z.K.komogllavë, 753 Sazli, 416-0 Z.K. Lloshkobare, 690-3 Z.K Talinoc i Jerlive, 1046-1 Z.K. Prelez i Jerlive, 1300-0 Z.K. Nerodime e Ulët dhe 1588-0 Z.K. Neredime e Epërme.
5. Vendim për shpallje interes i përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 705-3 dhe 705-4 Lloshkobare, pronë private me qëllim të këmbimit m epjesën e ngastrës kadastrale 706-0 Z.K. pronë e Komunës së Ferizajt.

5.10. Seanca e buxhetit në hije të akuzës për kërcënim

Mbledhja e nëntë e rregullt u mbajt më 29.09.2023. Është mbledhja e parë e Kuvendit Komunal të Ferizajt sivjet, që Komuna e ka transmetuar drejtpërdrejt, duke shpërndarë linkun e YouTube në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt në Facebook. Pas aprovimit të rendit të ditës dhe të procesverbalit të mbledhjes së kaluar, seanca ka vazhduar me pikën qendrore: Miratimi i projektbuxhetit për vitet 2024-2026.

Kryetari Agim Agliu ka paraqitur projektbuxhetin për vitin 2024 dhe projeksoinet për vitet 2025-26. Ka thënë se Ferizaj është lider në mesin e qendrave urbane me transformim në fusha të ndryshme. Ka premtuar zgjerimin e Parkut Liria, park në Lagjen e Sherretëve dhe ndërtimin e parkut te hapësira e “Pastërtisë”, por që ka disa vjet që premtohet e nuk bëhet asgjë për realizimin e tij,

Për infrastrukturë, ka folur gjerë e gjatë për nënkalimin për vetura e këmbësorë te Stacioni i Policisë. Kryetari Aliu ka premtuar kthimin në shesh të rrugës shesh nga rrethi te xhamia dhe kisha ortodokse deri te objekti i Teatrit Adriana. Aliu ka folur për projektet, por nuk ka treguar shifrat dhe afatet kohore për realizimin e tyre.

Flamur Istrefi nga LDK ka thënë se Komuna do të vazhdojë të përballet me përmbarime edhe vitin e ardhshëm. Ka thënë gjithashtu se janë reduktuar për mbi 200 mijë euro shumat për subvencione bujqësore. Te kategoria për “Mallra dhe shërbime” ka spikatur shumën prej 118 mijë euro në vit. Ka vënë në dyshim qëllimin e ndarjes së shumës për komunikim me publikun. Istrefi ka thënë se disa fshatra do të përfitojnë me disa projekte, por disa të tjera nuk do të preken fare me investime.

Adnan Selmani, nga LVV, ka shprehur shqetësimin për mungesën e gatishmërisë së qytetarëve për të marrë pjesë në dëgjime publike për hartimin e projektbuxhetit. Ai ka akuzuar ekzekutivin se nuk ka dëgjuar kërkesat e kuvendarëve dhe se është “projektbuxhet i zyrave”. Hatixhe Bungu, nga AAK në koalicion, nuk është pajtuar me opozitën për mospërfshirje të kërkesave të qytetarëve. Megjithatë ka kërkuar sqarime për mungesën e specifikimit të projekteve, si ai për kompleksin për personat me aftësi të kufizuara e për fusha sportive që nuk dihet se ku do të ndërtohen.

Ismaj Sejdiu nga Nisma në pushtet, ka kërkuar që të futet në projektbuxhet ndarja e fondeve për memorialin përkujtimor, të lënë në gjysmë mbi një dekadë, në fshatin Jezerc. Kërkesa nuk është marrë parasysh. Brahim Osmani nga VV i është drejtuar kryetarit me njoftimin se drejtori i tij i Shëndetësisë, Kemajl Emini, e ka kërcënuar pas seancës së kaluar të Kuvendit Komunal me fjalët: “Shihemi shihemi personalisht”. Osmani kishte ngritur dyshimin se i biri i drejtorit Emini kishte ndërruar etninë në gjendjen civile që të regjistrohej në Universitetin e Prishtinës në kuadër të kuotës së rezervuar për studentët nga pakicat. Ai përsëri ka thënë se kush janë zyrtarët që e kanë ndërruar etninë. Kryesuesi Xhavit Zariqi ka ndërhyrë. Por Osmani ka thënë se drejtori Emini do të duhej të jepte dorëheqje morale.

Në fund buxheti prej mbi 41 milionë eurosh u aprovua me shumicë votash.

Në këtë seancë ka kaluar edhe propozimvendimi për këmbimin e ngastrës Prelez i Jerlive, pronë private në pjesën e ngastrës 7-0 Z.K., Muhoc pronë e Komunës. Edhe tjetër mori mbështetjen e kuvendarëve për anulimin e vendimit të pjesërishëm të dy vendimeve – i pari më 05.11.2018 dhe i dyti marrë më 29.09.2020. Ka kaluar edhe propozim-vendimi për shpalljen Interes i përgjithshëm i ngastrave 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K., pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 295-I Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt. Është vendosur gjithashtu që të hidhet në diskutim publik të Planit komunal të vepërimit për shërbime sociale 2024-2026. Flamur Istrefi nga LDK ka thënë që të përshpejtohet plani për ndërtimin e objektit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçantë.

Në pikën e nëntë, është propozuar aprovimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës të 262-D zona kadastrale Babush i Ri. Drejtori Murseli ka kërkuar tre emra për Komision për zhvillimin e procedurave – dy kuvendarë dhe një nga OJQ. PDK-ja ka propozuar Valon Aliun. Adnan Selmani nga VV ka propozuar Amir Rexhepin. Hatixhe Bungu ka propozuar që sipas Rregullores së Kuvendit të bëhet thirrje publike që OJQ-të të propozojnë një emër. Arian Imeri ka propozuar Kenan Gashi. Kuvendi ka votuar dy kuvendarët e propozuar për anëtarë Komisioni. Në pikën e dhjetë, për një Komision tjetër për pronën 629-I u propozuan të jenë Amir Rexhep e Valon Aliu. Kuvendi ka votuar që OJQ-të ta dërgojnë një propozim pas konsultimeve të tyre.

Vendimet:

1. Miratimi i Projektbuxhetit për vitet 2024-2026
2. Vendimi për këmbimin e ngastrës kadastrale 1055-5 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private në pjesën e ngastrës kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc, pronë e Komunës së Ferizajt
3. Vendimi për anulimin e pjesërishëm të Vendimit me Nr. 01. Nr. 150 të datë 05.11.2018 dhe anulimin e Vendimit me Nr 01. 107 të datës 29.09.2020
4. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastrave kadastrale: 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt
5. Vendim për hedhjen në diskutim publik të Planit komunal të veprimtimit për shërbime sociale 2024-2026

6. Kuvendi në sytë e kuvendarëve dhe të shoqërisë civile

INPO ka zhvilluar pesë intervista me aktivistë të shoqërisë civile dhe me anëtarë të Kuvendit Komunal nga radhët e koalicionit në pushtet dhe të opozitës. Ndryshe nga opozita dhe shoqëria civile, që përgjithësisht ka vlerësime negative për punën e Kuvendit Komunal nga janari deri në shtator të këtij viti, pozita vlerëson se Kuvendi Komunal po aprovon strategji, plane e programe që janë të rëndësishme për jetën e qytetarëve.

6.1. (Jo)përfaqësimi

Por sa në të vërtetë i përfaqëson Kuvendi Komunal i Ferizajt qytetarët ferizajas, sidomos ata që votuan për kuvendarët aktualë?

Shqipron Xhema, gazetar

Shqipron Xhema, gazetar që ka përcjellë punën e Kuvendit Komunal si pjesë e Televizionit Tema në Ferizaj, vlerëson se Kuvendi Komunal i Ferizajt nuk e ka arsyetuar besimin e siguruar me votë nga qytetarët në zgjedhjet e vjeshtës së vitit 2021. Shpesh ka pika të rendit të ditës që miratohen pa u diskutuar fare nga kuvendarët. “Ka shumë prej asamblistëve që asnjëherë nuk kanë marrë fjalën në seancën e Kuvendit, nuk kanë diskutuar për pikat e rendit të ditës (ndoshta as nuk e lexojnë materialin...) e as nuk kanë ngritur ndonjëherë çështje me rëndësi për komunitetin në përgjithësi, apo për votuesit e tyre në veçanti”, ka thënë Xhema gjatë një interviste të gjatë lidhur me punën e organit më të lartë vendimmarrës të qeverisjes lokale. Madje ai mendon se duke llogaritur “mospunën e Kuvendit, mund të them që kjo legjislaturë nuk e kalon ‘provimin’, sepse nuk është legjislaturë që bën politika e as nuk e mban ekzekutivin llogaridhënës dhe transparent”.

Enver Kosumi, aktivist

Enver Kosumi, aktivist dhe drejtues i Handikos Ferizaj, thotë se anëtarët e Kuvendit të Ferizajt sivjet nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë a kauzë, të cilën do të mund ta shtynin përpara. “Mbledhjet i ka pasur kryesisht standarde e të rregullta. Deri tani nuk është mbajtur asnjë seancë solemne. Nuk mund të them diçka që ia vlen prej asamblesë”, ka thënë Kosumi.

Arian Imeri, PDK

Shefi i grupit më të madh parlamentar në Kuvendin Komunal, Arian Imeri, thotë se Kuvendi ka proceduar dhe aprovuar projekte, iniciativa e projekte për të cilat kishin votuar shumica e qytetarëve që kishin dalë në zgjedhjet e fundit lokale. Ka thënë se Kuvendi i ka aprovuar edhe kërkesat tjera që u dorëzuan në forma të ndryshme prej qytetarëve, duke vlerësuar se Kuvendi është “në nivel të detyrës”. Sipas tij, pengesa po paraqet niveli qendror nën qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje. “Kemi pengesa të shumta në këtë aspekt nga niveli qendror, si nga aspekti i respektimit të marrëveshjeve të trashëguara në mes Qeverisë dhe Komunës për projekte të ndryshme, si nga aspekti i nxjerrjes së vendimeve bllokuese, po ashtu edhe nga aspekti i përkrahjes me buxhet, siç e kemi rastin e fundit që zvogëlohet buxheti komunal, mirëpo ne do të

mundohemi me mundësitë komunale që sa më shumë të plotësojmë pritjet e qytetarëve”, ka thënë Imeri.

Brahim Osmani, VV

Anëtari më i zëshëm i Kuvendit Komunal të Ferizajt, Brahim Osmani, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në opozitë, vë në pah se Kuvendi Komunal kishte mbajtur seancën e parë të këtij viti pa plan vjetor pune, i cili do të miratohej vetëm në seancën e dytë. “Puna e Kuvendit nuk është se është marrë shumë seriozisht nga ana e ekzekutivit për arsye se ne nuk kemi raportime të drejtorëve para Kuvendit thuajse asnjëherë. Kemi seanca solemne për data të rëndësishme për qytetin, por edhe për vendin, që nuk janë mbajtur asnjëherë”, thekson Osmani. Sipas tij, pushteti po përdor “egon e numrave”, duke e ditur se opozita e ka të vështirë të sigurojë mbështetje për t’i ngritur çështjet e veta.

Flamur Istrefi, LDK

Flamur Istrefi, shëf i grupit të dytë më të madh parlamentar opozitar, thotë se periudha janarshtator është dokminuar prej temave ligjërish të obligueshme, “siç janë Korniza Afatmesme Buxhetore, buxheti, raporti i auditorit, raportet e kryetarit të Komunës, plani i punës së Kuvendit, apo “tema që i kemi pasur obligative për t’i kaluar”. “Përveç kësaj ka pasur tema që i ka sjellë ekzekutivi, si strategji si të ndryshme që realisht kanë kaluar, por në realitet është problem që të implentohen. Tjetër, ka pasur propozim-vendime për plotësim ose ndryshim të vendimeve paraprake, të cilat Ministria i ka kthyer si të kundërligjshme, që është dashur gjithmonë me i votu ka dy-tri herë, për shkak se Komuna nuk ka qenë korrekte kur e ka sjellë materialin”, ka thënë Istrefi i LDK-së.

6.2. (Jo)transparenca

Por sa është transparent Kuvendi Komunal i Ferizajt, sepse ka pasur raste kur opozita, por edhe anëtarë të pozitës në Kuvend, janë ankuar se materialet u janë dorëzuar me vonesë – duke thënë se po shkelen afatet ligjore për përgatitje para seancës?

Shqipron Xhema, gazetar

Gazetari Xhema thotë se mungesa e transmetimit të seancave të Kuvendit Komunal të Ferizajt, sikur se përcaktohet me ligj, ua pamundëson qytetarëve që të shohin se çfarë vendimesh merren për jetën e tyre. Pasqyrimi i punës së Kuvendit varet kryesisht nga raportimet e tri medimeve televizive ferizajase në edicione lajmesh, apo nga postimet në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt në Facebook, që “zakonisht nuk shpërfaqin shpërfaqin në mënyrën e duhur kundërshtinë e opozitës apo edhe ‘përgjumjen’ e asamblistëve që dinë vetëm të ngritin dorën”. “Mungesa e materialeve sigurisht që ka vështirësuar punën e kuvendarëve në disa nga seancat e Kuvendit Komunal sivjet. Problematikë e vazhdueshme është që materialet janë pa ngjyra dhe shpesh kur këmbëhet ndonjë pronë apo nëse ka ilustrime ndonjë material, është vështirë i kuptueshëm”, thekson Xhema.

Brahim Osmani, VV

Brahim Osmani nga VV thotë se kuvendarëve shpesh u mungojnë materialet elektronike dhe fizike për përgatitje me kohë për pikat e rendit të ditës, sikur se kërkohet edhe sipas afateve ligjore. “Kemi pika për të cilat materialet nuk na dërgohen hiç, ose kemi pasur deri në pesë-gjashtë pika që na janë sjellë atypëraty. Realisht kemi kërkuar që materialet të jenë me kohë, mirëpo nuk na ka ndodhur për shkak se kemi edhe shumë pika të rëndësishme, për të cilat pika nuk jemi të përgatitur qysh duhet edhe për shkak të obligimeve që ne i kemi ndaj qytetarëve”, thekson Osmani. “Kemi pasur sidomos këmbime të pronave të cilat janë sjellë atypëraty dhe kurrë nuk janë sjellë materialet. Dhe nëse e sheh materialin, edhe nuk mund ta dish se ku qëndron prona, materialet janë pa ngjyra, nuk dihet fare ku janë ato prona. Mirëpo, ky ekzekutiv mund të them se punën më të madhe e ka përqendruar te ndërrimet e pronave dhe këmbimet e pronave”.

Flamur Istrefi, LDK

Flamur Istrefi thotë se ka pasur senacë në të cilën të gjitha pikat e rendit të ditës kanë kaluar pa material elektronik. “Nuk e kemi ditur çfarë po votojmë. Ne kemi qenë kundër të gjitha pikave, pos KAB-it që e kemi diskutuar, jo për shkak të përmbajtjes, por për shkak se nuk e kemi ditur çfarë ka në ato pika. Pushteti i ka kaluar komplet. Kuvendarët i kanë kaluar pa i pasur materialet, as na e as ata”, thotë Istrefi, duke treguar se ngjashëm ka ndodhur edhe me një procesverbal seance që Kuvendi Komunal e ka nxjerrë në votim pa ua dërguar kuvendarëve. “Na e kemi votuar, do të thotë është kontrabandim dhe nuk ke si i thu tjetër”, thekson Istrefi.

Arian Imeri, PDK

Edhe Arian Imeri e pranon se ka pasur raste kur materialet nuk u janë dërguar anëtarëve të Kuvendit Komunal. Kjo, sipas tij, ka ndodhur “kryesisht në raste kur pikat janë proceduar me vonesë, apo gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mirëpo prapë jemi furnizuar me materialin e nevojshëm”. Ai thotë se materialet kanë munguar për shkak të “interesit për ta proceduar më shpejt një pikë të rendit të ditës dhe jo si tendencë me qenë jotransparent me atë pikë, apo qëllime tjera”. Sipas tij, “të paktën deri tani nuk kemi asnjë rast të tillë. Në disa raste ka qenë edhe kërkesa e opozitës që të procedohet ndonjë pikë, siç është rasti i Çerdhes në fshatin Dardani, por ka edhe raste kur pika të cilat nuk i kemi konsideruar urgjente edhe nuk i kemi procedu pa u kompletuar me kohë siç duhet”

6.3. “Arroganca” e pozitës përballë opozitës dhe qytetarëve

Ndërmarrjet publike komunale ende nuk i kanë raportuar Kuvendit Komunal, edhe pse e kanë për obligim që të raportojnë në fillim të vitit. Pushteti e opozita kanë shëmbyer akuza e kundëraakuza për vonesat. Opozita ka ngritur dyshime në pretendimet e pozitës se ndërmarrjet publike së pari duhet t’i hartojnë raportet e tyre financiare dhe të kryejnë auditimet para se t’i raportojnë Kuvendit. Akuza të ngjashme janë ngritur edhe ndaj drejtorëve që në shumicën e rasteve mungojnë në seanca. Por cili në të vërtetë është raporti i Kuvendit me ekzekutivin?

Shqipron Xhema, gazetar

Xhema thekson se nuk ka asnjë mëdyshje se raporti është si mos më keq. Së pari, sipas tij, ekzekutivi lokal injoron Kuvendin Komunal. “Kur e them këtë e bazoj në atë që së pari kryetari i Komunës nuk merr pjesë në seancat e Kuvendit, përveç në ato që e ka obligim ligjor (ta zëmë, raportimi gjashtëmujor), nënkryetarët në shumicën e seancave nuk marrin pjesë e as shumë nga drejtorët komunalë nuk janë prezentë në seanca”, thekson ai. “Derisa Kuvendi injorohet nga ekzekutivi, janë kuvendarët e shumicës parlamentare që janë shndërruar pikërisht në ‘makineri vote’ që nuk lexojnë materiale, votojnë gjithçka që vjen nga ekzekutivi e që nuk janë në gjendje të ngrisin zërin e tyre për thuajse asgjë. Nga ajo çfarë kam vërejtur është që legjislativi (shumica parlamentare) nuk e dinë apo nuk duan të dinë që detyrë e tyre është edhe mbikëqyrja e punës së ekzekutivit e mbajtja e ekzekutivit llogaridhënës para tyre dhe qytetarëve, e jo vetëm votimi i pikave të rendit të ditës, që sillen nga pushteti apo luajtja e rolit të zëdhënësit të ekzekutivit”.

Flamur Istrefi, LDK

Flamur Istrefi i vjen keq për mënyrën sesi votojnë e diskutojnë kolegët kuvendarë nga pozita. Ai tregon se gjatë bisedave private me ta, e ka kuptuar se nuk veprojnë pavetëdijshtëm, “por e kanë obligim prej pushtetit që të votojnë”. “...ata e kanë kthyer Kuvendin në makineri vote, ku me keqardhje e them se kuvendarët pa marrë parasysh çfarë propozimi vjen dhe pa marrë parasysh arsyetimin që e bëjmë si opozitë që është edhe në dëm të qytetarëve të komunës, propozimin nuk ta mbështesin në çfarëdo forme. Kjo arrogancë vjen për shkak të numrave që i kanë e jo për diçka tjetër”, thekson Istrefi, duke shtuar se mosraportimi i ndërmarrje komunale po lihet qëllimshëm për fundvit kur vëmendja e qytetarëve është tek festat dhe pushimet dimërore. “Miniqeveria e Komunës janë këto ndërmarrje publike, që nga kryeshefat ekzekutivë, bordet e deri te punëtorët janë shumica prej tyre militantë politikë. Janë anëtarë të partive në pushtet, edhe aty shihet qeverisja, mund të them miniqeverisja e kryetarit Aliu”, thotë ai.

Arian Imeri, PDK

Arian Imeri thotë se PDK-ja mendon se është më mirë që ndërmarrjet komunale t’i raportojnë Kuvendit në fundvit. “Në të kaluarën ka qenë praktikë që zakonisht ndërmarrjet publike të raportojnë në muajin prill për vitin e kaluar. Mirëpo unë përkrah këtë formë të raportimit, sepse është më transparente që raportimi në Kuvend të bëhet pasi të publikohen raportet e jashtme të auditimit dhe anëtarët e Kuvendit para vetes të kenë raportin e ndërmarrjes publike, i cili mund edhe të jetë subjektiv dhe raportin e një organi të pavarur, siç është Zyra Kombëtare e Auditimit”, thekson ai, duke i mëshuar fort në të tijën se kështu rritet transparenca. Imeri është kundër kërkesës së opozitës që të raportohet vetëm nga bordi i aksionarëve.

Brahim Osmani, VV

Brahim Osmani i VV-së përmend rastin kur kuvendarët e shumicës nuk e kishin marrë parasysh një kërkesë të shkruar të kryesisë së Prelezit të Muahxherëve që të mos jepej në shfrytëzim toka

komunale pa kërkuar respektim të kushteve mjedisore për shkak se po përballëshin me probleme me bizneset aktuale. “Nuk është që kanë qenë kategorikisht kundër, por kanë thënë se po ka pengesa për shkak se prodhimet që bëhen aty janë pengesë për banorët që janë aty”, thekson Osmani për përmbajtjen e letrës së Prelezit të Muhaxherëve, dërguar shefave të grupeve parlamentare, por që shumica e votoi pavarësisht ankesave të komunitetit. “E thashë edhe në fillim se arroganca e tyre ka arritur kulmin. Nëse e shohim buxhetin, por edhe takimet me qytetarë, qytetarët janë të dëshpëruar nuk vijnë nëpër takime dhe nuk vijnë në dëgjime publike, sepse idetë dhe propozimet e tyre nuk është se janë marrë parasysh asnjëherë”, thotë Osmani. “Dhe gjithashtu në buxhet, kemi pasur rastin vitin e kaluar në fshatin më të madh në Greme, kanë qenë katër persona. As kryetari i fshatit nuk na ka ardhur”.

Enver Kosumi, aktivist

Enver Kosumi i Handikos Ferizaj thotë se kuvendarët kanë lënë anash dallimet partiake gjatë hartimit të Planit për shërbime sociale, i cili është nxjerrë për diskutim publik, porse ende nuk është aprovuar. “Një pjesë e madhe e asambleistëve kanë shprehur dëshirën të jenë pjesë e atyre ndryshimeve, mirëpo për shkak të numrit të kufizuar, është dashur edhe ne t'i kufizojmë, domethënë t'i përzgjedhim një grup që kanë qenë më të zëshëm sa u përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuar”, thekson Kosumi. “Në këtë rast nuk ka ndonjë ndryshim pozitiv-opozitë, që kanë qenë pjesë e takimeve, mbledhjeve dhe grupeve të fokusit, të cilat i kemi mbajtur thuajse gjatë një viti të hartimit dhe përfundimit të Planit lokal të veprimit”.

6.4. Opozita “pikë e pesë”

Opozita në Kuvendin Komunal ka dallime. Janë dallime që nganjëherë reflektojnë edhe pikëpamjet e ndryshme të nivelit qendror të VV-së në pushtet dhe LDK-së në opozitë. Por kanë qenë disa seanca kur anëtarët e VV-së në opozitë në Kuvendin Komunal të Ferizajt kanë votuar me dy mendje, ose kanë votuar kundër shumicës së bashkëpartiakëve. Demonstrimi i pakënaqësisë së disa kuvendarëve kundrejt kolegëve bashkëpartiakë ka treguar se kjo nuk ka ndodhur për shkak të parimeve të tyre të qëndrueshme, por si pasojë e mungesës së koordinimit paraprak.

Shqipron Xhema, gazetar

Shqipron Xhema konsideron se opozita në Ferizaj “është shumë e dobët, thuajse joekzistente”. Sipas tij, kjo ndodh për shkak se shumica parlamentare ka fuqinë që të kalojë çdo pikë të rendit të ditës, pavarësisht kundërshtimit opozitar. “Por që problemi i opozitës ferizajase vjen edhe nga vet ajo. Kur them që problemi vjen nga vet opozita, e kam fjalën se shohim një opozitë të pakoordinuar në shumicën e rasteve, votimet edhe brenda një partie opozitare shpesh dallojnë”. Ai thotë se dy partitë më të mëdha opozitare kanë “edhe problemet e veta brenda partisë(VV-ja ka një kryetare që ka ardhur në opozitë si kompromis e LDK-ja ka kryetar dege të ri e që ka një vit që nuk e ka zgjedhur kryesinë e degës), pra problemet e brendshme partiake e disa herë edhe ‘bërrylat’ brenda partisë shfaqen edhe në Kuvendin Komunal”.

Arian Imeri, PDK

Arian Imeri thotë se opozita duhet të dalë me propozime të qarta që të marrë mbështetjen e kuvendarëve të shumicës. “Me keqardhje e them, mirëpo kemi shumë pak propozime konkrete nga opozita, përkundër që nga ato që i kanë pasur, siç kanë qenë disa për raportim apo informata nga drejtorët komunalë i kemi përkrahur shumicën e tyre. Unë nuk di ndonjë kërkesë që kishte me ndiku në jetën e qytetarëve që ka pasur opozita, përveç rastit të faljes së obligimeve të tatimit deri 100 euro për të cilin ne ju ofruam mbështetjen tonë”, por që vendimi i nivelit qendror është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese dhe pozita insiston që Kuvendi Komunal i Ferizajt të presë vendimet përfundimtare të nivelit qendror.

Flamur Istrefi, LDK

Flamur Istrefi i LDK-së thotë se grupi i tij parlamentar i mban nga dy mbledhje para çdo takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe seancave të rregullta të Kuvendit Komunal për t’u përgatitur dhe ndarë përgjegjësitë e kuvendarëve të LDK-së. “Domethënë jemi në koordim të plotë deri tash, unik deri tash si LDK në Kuvend. Sa i përket bashkëpunimit me VV-në, mendoj se në shumtën e rasteve, 90 për qind kemi qenë me një pikë, sa u përket proceseve duke marrë parasysh keqpërdorimet e pushtetit, por kanë qenë disa tema që na kanë bërë me u da, ka qenë për shembull falja e tatimit në pronë, që ka qenë porozim qeveritar, dhe që ne kemi pasur alternativa dhe propozime tjera”, thekson Istrefi. “Në të kaluarën ka qenë themelimi i tri drejtorive të reja, që ne realisht ishim me dalë në diskutim publik për shkak se kemi menduar se duhet të jetë Drejtoria e Inspektoratit, e kemi pasur edhe në program e që ata kanë qenë kundër. Te hartat zonale na kemi qenë kundër, ata kanë qenë pro”.

Brahim Osmani, VV

Brahim Osmani, nga VV-ja, thotë se krahasuar me vitin e kaluar, LDK e VV kanë përafëruar qëndrimet gjatë diskutimeve dhe qëndrimeve për votim të propozim-vendimeve të pushtetit në Kuvendin Komunal. “Sepse sivjet kemi pasur dakordime dhe mendoj se do të vazhdojmë deri në fund. Kemi raste kur nuk kemi dakordime se (LDK-ja, v.j.) kanë idetë e veta që mund të vijnë edhe nga lart. Opozita duhet të jetë më aktive pa diskutim”, thotë Osmani.

6.5. Debati “i mbytur” publik

Në legjislaturat e kaluara, pavarësisht se cila parti udhëhiqte koalicionin në pushtet, apo cila ishte më e madhja në opozitë, kishte debat më të madh në seanca të Kuvendit Komunal, por që reflektonte edhe jashtë detyrës së tij, si në media e mjedise të ndryshme publike. Tani pakkush merr vesh qartësisht për vendimet që merr Kuvendi Komunal si organi më i lartë vendimarrës i qeverisjes lokale. Debate të herëpashershme zhvillohen në rrjete sociale, ku dominon fryma e militantizmit partiak.

Enver Kosumi, aktivist

Aktivisti Enver Kosumi thotë se ka vite prejse mungon debati i mirëfilltë publik për vendimet e Kuvendit dhe ekzekutivit në qytet. “Është një kohë e gjatë sikur njerëzit e kanë humbur fuqinë për t’u përballur me problemet dhe me çështjet. Vërehet një lëshim i gjendjes me rënie të lirë, ‘le të rrjedhë si të rrjedhë se mundësia me ndryshu është shumë e vogël’”, thekson Kosumi. Ai mendon se mospërfshirja e qytetarëve në debat vjen edhe për shkak se ngrihen shumë çështje përnjëherësh dhe secila nuk diskutohet më shumë se dy-tri ditë. “Nuk po them ndoshta serioziteti, por kur institucionet nuk merren me një problematikë, atëherë kush ka me u marrë. Ta zëmë është ngritur që sa vite çështja e qasjes në ambiente publike e personave me aftësi të kufizuara, ka llafe të mira, ka muhabetë të mira, mirëpo një iniciativë nuk ka. Iniciativë konkrete nuk ka. Që sa vite për shembull ndahet buxhet sa për sy e faqe për ndërtimin e një qendre për personat me aftësi të kufizuara, që tri katër vite ndahen qato mjete dhe barten nga viti në vit dhe aksush nuk e merr një iniciativë me ba një plan, me nda parcelën, me jetësu, mirëpo thjesht ajo sa për letra, domethënë me nejtë kishe jam duke ba diçka, mirëpo realisht deri sot nuk është ba kurrëgjia”.

Shqipron Xhema, gazetar

Xhema ndjen keqardhje që “nuk ka fare zë kritik” në Ferizaj. Madje gjendjen e konsideron të mjerë. “Ka shumë njerëz që për shkak të servilitetit të tepruar vendosin të shohin vetëm bardh, por jo edhe ngjyrat tjera që gjenden në punën e ekzekutivit të Komunës sonë. Ka nga qytetarët që kanë zë kritik, por që vetëmjatftohen me diskutime nëpër kafene”, thekson ai. “Unë besoj që grupi i dytë i njerëzve janë ata që më së shumti po e dëmtojnë qytetin tonë. Me mungesën e një qytetari aktiv që nuk kritikon, nuk ankohet asnjëherë e nuk kërkon më shumë nga pushteti lokal, ne po shohim një ekzekutiv arrogant që edhe zërat më të voegjël kritikë në dëgjime publike tentojnë t’i ‘mbysin’”, thotë Xhema. Ai beson se kërkesat e qytetarëve aktivë mund ta ndryshojnë mendësinë e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Komunën e Ferizaj. “Besoj që bashkëqytetarët e mi duhet të vendosin me u bë të guximshëm, me e ngrit zanin për nevojat dhe kemi nevojë me fol për problemet që i kemi në komunitetin tonë e që kur nuk kemi trotuar, nuk kemi ujë të pijshëm, nuk vjen ‘Pastërtia’ me i marr mbeturinat, apo nuk kemi çerdhe e ambulante afër na me u ‘çu prej gjumit’ e me ia ‘nxan’ derën kryetarit për me na i plotësu kërkesat e jo me mbet ankesat në tavolina të kafeneve”.

Brahim Osmani, VV

Brahim Osmani i VV-së nuk është i kënaqur as me mënyrën sesi po raportojnë disa media për zhvillimet e vendimet e Kuvendit Komunal. “Përjashtoj mediumet televizive, disa të tjera nuk kanë nxjerrë punë të keqe të kryetarit Aliu, sepse kur kemi një raport të auditimit, të cilin e ka pranuar edhe ai vetë, pse të mos qitet në pah që ka keqpërdorime të tmerrshme”, thekson Osmani. “Edhe qytetarët nuk e kanë parë këtë, por mendoj se edhe shoqëria civile duhet të jetë më e zëshme. Duhet të jetë më e ndërlidhur edhe puna edhe e anëtarëve të opozitës në Kuvend, edhe shoqërisë

civile për ta arritur një qëllim të caktuar. Por edhe nëse bëhen punë të mira nuk është se kemi me ik”.

Arian Imeri, PDK

Arian Imeri i PDK-së thotë se “fatkeqësisht gjendja e debatit publik është e njëjtë në të gjithë Kosovën dhe në të gjitha pushtetet”. Ai e pranon se qytetarët nuk kanë besim në debatet publike, prandaj sipas tij, duhet në mobilizim i të gjithëve, përfshirë OJQ-të, për të gjetur mënyrën që të rritet besimi i qytetarëve dhe “t’i bëjmë ta kuptojnë që pjesëmarrja në debate është e vlefshme për ta dhe se mendimi i tyre ka peshë”.

Flamur Istrefi, LDK

Flamur Istrefi i LDK-së thotë se mediat lokale, “përveç Televizionit Tema që mundohet të jetë më aktiv duke shfaqur parregullsitë dhe keqpërdorimet”, televizionet tjera realisht, sipas tij, janë kthyer në “shpërndarëse të lajmeve dhe informatave të Agim Aliut, kryetarit të Komunës”. “Do të thotë nuk ka diçka hulumtim, ose diskutim. Prej OJQ-ve realisht është INPO që në të kaluarën ka qenë shumë më aktive. Po flas para dhjetë viteve ndoshta, e ka nxitur një debat, edhe temat që i kemi shtjelluar na kanë bërë edhe ne me qenë më aktivë”, thekson Istrefi. “Ka pasur brum, ka pasur analiza të INPO-s, ka pasur përballje pushtet-opozitë, dhe kisha pas qejf me pa edhe një herë një organizim të tillë. Unë vetë kam qenë në katër-pesë debate nëse nuk gaboj që i ka organizu INPO dhe për mua kanë qenë edhe të mira si Flamur për t’u zhvilluar për të ardhmen, por edhe me tregu parregullsitë se ka qenë mënyra e vetme atëherë”, thotë ai.

7. Konkluzionet

- Kuvendi Komunal i Ferizajt gjatë periudhës nëntëmuajore janar-shtator nuk ia ka dalë të përmbushë misionin e tij për të marrë nisma e nxjerr vendime që do të ndikonin bindshëm në jetën e qytetarëve të Ferizajt. Kuvendi Komunal i Ferizajt është kthyer në makineri vote e propozim-vendimeve që sillen nga ekzekutivi. Në Kuvendin Komunal të Ferizajt mungon debati i mirëfilltë, që do të fuqizonte rolin e demokracisë lokale dhe rritjen e shkallës së llogaridhënies së pushtetit lokal para qytetarëve, të cilët i kanë mandatuar përfaqësuesit politikë për të hartuar politika për të mirën e përbashkët.
- Kuvendi Komunal e ka nisur seancën e parë të këtij viti pa një plan të hartuar e të aprovuar pune. Kjo dëshmon mungesën e seriozitetit jo vetëm të kuvendarëve të koalicionit qeverisës, por të gjithë anëtarëve pa dallim politik. Madje edhe kur në seancën e dytë u aprovua Plani vjetor i punës, anëtarët që ishin pjesë e Komisionit për hartimin e tij, konfirmuan se nuk ishin të informuar me kohë nga kryetari i Komisionit për përmbajtjen dhe se nuk kishin kohën e nevojshme për ofrimin e rekomandimeve të mundshme.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt vetëm në seancën e nëntë të rregullt në fund të shtatorit e ka transmetuar mbledhjen drejtpëdrejt në Youtube. Madje, linku i seancës është shpërndarë vetëm në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt në rrjetin social Facebook.
- Shumica e vendimeve të Kuvendit Komunal të Ferizajt lidhen me këmbimin dhe dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të ngastrave komunale për biznese, por edhe për qytetarë, përderisa opozita disa herë ka ngritur dyshime se Kuvendi Komunal i Ferizajt, si organi më i lartë i qeverisjes lokale, është kthyer në institucion që po legalizon uzurpimet e pronave komunale nga biznese e qytetarë të papërgjegjshëm.
- Në shumicën e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit Komunal të Ferizajt nuk merr pjesë kryetari i Komunës dhe drejtorët e kabinetit të tij. Shumica bindëse e kuvendarëve në koalicionin legjislativ ka shkaktuar mungesë gatishmërie të ekzekutivit për të marrë pjesë në seanca dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të kuvendarëve edhe atëherë kur nuk diskutohen çështje a vendime të lidhura drejtpëdrejt me drejtori të caktuar.
- Ndërmarrjet publike komunale ende nuk i kanë raportuar Kuvendit Komunal të Ferizajt për shkak se kanë mbështetjen e kuvendarëve të koalicionit, të cilët preferojnë që raportimi i tyre të bëhet në fund të vitit, atëherë kur vëmendja e qytetarëve është e përqendruar te festat e fundvitit dhe nisin pushimet dimërore.
- Opozita në Kuvendin Komunal të Ferizajt nuk është e organizuar dhe nuk ka vizion të qartë. Ajo reflekton ndasi në rastet edhe kur bëhet fjalë për vendime që lidhen

drejtpërdrejt me politika e planet lokale. Madje ka raste kur anëtarët e së njëjtës parti opozitare, votojnë ndryshe, ose edhe shprehin haptas pakënaqësinë me mënyrën e votimit të bashkëpartiakëve. Shihet qartazi se ka moskoordinim paraprak brendapartiak.

- Kuvendi Komunal i Ferizaj nuk ia ka dalë të krijoj ura komunikimi dhe bashkëpunimi me qytetarë. Dëgjimet publike që organizohen nga Kuvendi janë formalitete që mbahen në sallën e Kuvendit, e ku marrin pjesë vetëm disa përfaqësues OJQ-sh e disa kryetarë fshatrash, tashmë pa mandat zyrtar. Kjo pasqyron mungesën e përkushtimit të Kuvendit për të siguruar pjesëmarrje të palëve të interesuara në njërën anë, dhe në anën tjetër demonstroi mungesën e informimit të qytetarëve rreth rolit të rëndësishëm të Kuvendit Komunal.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt nuk i publikon mëkohë në uebfaqen e Komunës së Ferizajt të gjitha procesverbalet dhe vendimet edhe disa javë pas miratimit të tyre, duke ngjallur pakënaqësi se mos po vihet në dyshim ligjshmëria e tyre nga MAPL-ja. Këto dyshime ngrihen shpesh, por nuk ka një përgjigje të qartë.
- Anëtarët e Kuvendit Komunal, të pozitës e të opozitës, janë ankuar gjatë disa seancave të sivjetme se nuk u janë dorëzuar materialet me kohë. Edhe kur është ngritur nga opozita kjo çështje, kryesuesi e ka kaluar me pretendime të stilit se “keni telashe me pajisjet teknologjike”.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt sivjet nuk ka mbajtur asnjë seancë solemne, megjithëse nga janari deri në shtator, ishin datat e 15-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, përvjetorit të Epopesë së UÇK-së në mars, Ditës së Çlirimit të Ferizajt në qershor, apo edhe 25-vjetori i Epopesë së Jezercit në fundstator, por sivjet po shënohet edhe 150-vjetori i themelimit të qytetit.

8. Rekomandimet


- Kuvendi Komunal i Ferizajt duhet të ndryshojë thelbësisht mënyrën e funksionimit, me qëllim që të merren seriozisht kërkesat dhe shqetësimet e ngritura jo vetëm nga anëtarët e kuvendit, por edhe grupet e ndryshme të interesit dhe qytetarët. Kuvendi Komunal duhet të ketë një strategji të qartë sesi të mobilizojë komunitetet e qytetarët e të zonave të ndryshme për adresimin dhe zgjidhjen e shqetësimeve dhe kërkesave të përbashkëta. Kuvendarët duhet të jenë më aktivë me përfshirje më të madhe në fushata të ndryshme për të mirën e përbashkët shoqërore.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt duhet të kujdeset që para vitit 2024 ta ketë të hartuar e të aprovuar Planin vjetor të punës për vitin e ardhshëm, me qëllim që të mos kthehet në precedent rasti i sivjetmë kur seanca e parë e vitit të ri kalendarik nisi pa plan vjetor pune. Ai duhet të draftohet e të debatohet mirëfilltas para se të aprovohet në Kuvend.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt duhet t'i transmetojë të gjitha seancat drejtpërdrejt, por edhe t'i ketë të postuara në uebfaqen zyrtare të Komunës së Ferizajt, që qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit të kenë qasje të lehtë dhe të përhershme në to, sepse këtë shërbim e ka detyrë ligjore administrata e Kuvendit.
- Kuvendarët ferizajas duhet të ngrehin zërin për mënyrën sesi u dorëzohen propozim-vendimet për këmbimin dhe dhënien në shfrytëzim afatshkurtër e afatgjatë të ngastrave të Komunës së Ferizajt. Ekzekutivi duhet të jetë më transparent me ofrimin e materialeve dhe sqarimeve të sakta, për arsyet e këmbimit apo dhënies së ngastrave komunale bizneseve, apo edhe qytetarëve privatë.
- Kryetari dhe drejtorët e kabinetit të tij duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhje të Kuvendit Komunal për shkak se duhet të japim sqarime për propozim-vendimet e ekzekutivit, por edhe e kanë obligim t'u përgjigjen edhe pyetjeve e shqetësimeve të kuvendarëve në pikat e rendit të ditës, "Të ndryshme" dhe "Pyetje e përgjigje". Kësisoj kryetari dhe drejtorët në të vërtetë u përgjigjen kërkesave të qytetarëve, të kanalizuar nëpërmjet kuvendarëve.
- Ndërmarrjen publike komunale e kanë detyrim ligjor që t'u raportojnë kuvendarëve për mënyrën e funksionimit të kompanive të tyre. Fakti se Stacioni i Autobusëve u detyrua t'i kërkonte Kuvendit mbi 59 mijë euro për të kompensuar një ish-punëtor, pasi e kishte fituar rastin në gjykatë, tregon se ndërmarrjet publike komunale gëzojnë mbështetjen e shumicës, pavarësisht kritikave të opozitës për keqqeverisje.

- Partitë opozitare të Ferizajt duhet t'i bashkërendojnë më mirë e paraprakisht qëndrimet e tyre kur diskutohen vendime të Kuvendit Komunal të Ferizajt, të cilat konsiderohen kundërthënëse edhe në fazën e hartimit dhe të diskutimit të tyre. Pavarësisht ndasive që reflektohen shkak i qëndrimeve të ndryshme partiake në nivel qendror, kuvendarët opozitarë mund t'i tejkalojnë dallimet për interesin e përbashkët të qytetarëve.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt duhet të jetë më aktiv për ngritjen e gatishmërisë së qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjime e konsultime publike, por edhe gjatë hartimit dhe marrjes së vendimeve të kuvendarëve që ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme dhe në politikat publike në përgjithësi. Kuvendi Komunal duhet të ketë fushata konkrete me përfshirje të kuvendarëve në takime në komunitet në zona urbane e rurale, por edhe me anëtarë të grupeve të ndryshme të interesit. Kështu Kuvendi ngrit vetëdijen shoqërore për rëndësinë e gjithësecilit qytetar në jetën publike.
- Kuvendi Komunal i Ferizajt duhet t'i publikojë me kohë të gjitha materialet në uebfaqen e Komunës së Ferizajt, me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies, sepse debati publik i lidhur me to nxit pjesëmarrje të qytetarëve dhe fuqizon demokracinë lokale si një prej vlerave themelore të sistemit aktual kushtetues të Republikës së Kosovës.
- Administrata e Kuvendit Komunal duhet të kujdeset që t'i respektojë detyrimet ligjore për dorëzimin me kohë të të gjitha materialeve të domosdoshme për kuvendarët para çdo seance, për shkak se në mungesë të materialeve, jo vetëm kuvendarët e pozitës dhe opozitës, por edhe qytetarë, OJQ-të dhe mediat nuk do të kenë mundësi të kuptojnë qartazi përmbajtjen, mënyrën dhe qëllimin e marrjes së vendimeve të Kuvendit Komunal.
- Kuvendi Komunal duhet të mbajë mbledhje solemne për përvjetorë të rëndësishëm të vendit dhe të komunës, ku mund të përkujtohen ngjarje e të nderohen personalitete të ndjera e të gjalla që kanë pasur rol vendimtarë në historinë e shtetndërtimit të Kosovës.



Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.

 +383 (0) 49 354 000

 info@inpo-ks.org

 www.inpo-ks.org

